PHRASEOLOGICAL UNITS CONTAINING NAMES OF LIVING BEINGS IN THE ALBANIAN LANGUAGE: WORD FORMATION, SEMANTIC CLASSIFICATION AND LEXICOGRAPHIC REPRESENTATION

Adelina LAÇI

Doktorante pranë Universitetit të Elbasanit, Shqipëri, adelina.laci@yahoo.com

Abstract

This study examined phraseological units in the Albanian language containing names of living beings, with particular emphasis on their word-formation features, semantic classification and lexicographic treatment. The analysis focused on phraseological units containing names of domestic animals, wild animals, birds and fish, which were used figuratively to describe different human characteristics, behaviours and attitudes. From a structural and word-formation perspective, the study identified the main patterns through which these units were formed, paying particular attention to metaphor and comparison as mechanisms of figurative meaning construction. From a semantic perspective, the phraseological units were classified according to the human characteristics they expressed, including physical appearance, character traits, intellectual abilities, emotional states, behaviour and moral qualities. Furthermore, the study distinguished between units with positive and negative evaluative connotations, highlighting the role of animal names in expressing human qualities and shortcomings. An important part of the research involved examining the representation of these phraseological units in three Albanian dictionaries: Fjalori i gjuhës shqipe (1954), Fjalori i gjuhës së sotme shqipe (1980) and Fjalori i gjuhës shqipe (2006). Their comparative analysis provided insight into the inclusion, treatment and continuity of these expressions in Albanian lexicographic practice. The study highlighted the richness of Albanian phraseology, the figurative potential of animal names and the cultural significance of these expressions in reflecting human character and behaviour.

Keywords: phraseological units, domestic animals, wild animals, birds, fish, semantic classification.

Hyrje

Frazeologjia përbën një nga fushat më të rëndësishme të leksikut të një gjuhe, pasi pasqyron jo vetëm pasurinë shprehëse të saj, por edhe përvojën historike, kulturore dhe shoqërore të një bashkësie gjuhësore. Nëpërmjet njësive frazeologjike, gjuha shpreh në mënyrë të figurshme mendime, qëndrime, vlerësime dhe përvoja të ndryshme njerëzore. Këto njësi dallohen për qëndrueshmërinë strukturore dhe për kuptimin e tyre të veçantë, i cili jo gjithmonë përputhet me shumën e kuptimeve të fjalëve përbërëse.

Një grup i veçantë brenda frazeologjisë së gjuhës shqipe përbëhet nga njësitë frazeologjike që kanë në përbërjen e tyre emërtime gjallesash. Këto njësi paraqesin interes të veçantë gjuhësor dhe semantik, sepse emërtimet e kafshëve shtëpiake, kafshëve të egra, shpendëve dhe peshqve përdoren shpesh në mënyrë metaforike dhe krahasuese për të karakterizuar njeriun. Nëpërmjet tyre shprehen tipare të ndryshme të karakterit, sjelljes, pamjes fizike, aftësive mendore dhe gjendjes emocionale të individit. Kështu, bota e gjallesave shërben si një burim i rëndësishëm figuracioni për pasqyrimin dhe vlerësimin e botës njerëzore.

Interes të veçantë në këtë studim paraqet mënyra e formimit të këtyre njësive, modelet e tyre strukturore dhe mekanizmat gjuhësorë që kanë ndikuar në krijimin e kuptimeve të figurshme. Gjithashtu, rëndësi merr klasifikimi i tyre sipas asaj që shprehin për njeriun, duke dalluar njësitë që karakterizojnë tipare pozitive nga ato që shprehin tipare negative. Ky klasifikim mundëson evidentimin e mënyrës se si gjuha shqipe përdor emërtimet e gjallesave për të shprehur vlerësime të ndryshme për individin dhe sjelljen e tij.

Një tjetër aspekt i trajtuar në këtë punim është pasqyrimi i këtyre njësive në veprat kryesore leksikografike të shqipes, konkretisht në Fjalorin e gjuhës shqipe (1954), Fjalorin e gjuhës së

https://doi.org/10.62792/ut.icfra.y2026.i2.pp108

sotme shqipe (1980) dhe Fjalorin e gjuhës shqipe (2006). Krahasimi i këtyre tri fjalorëve synon të evidentojë mënyrën e përfshirjes dhe të paraqitjes së njësive frazeologjike, si dhe ndryshimet ose vazhdimësinë në trajtimin e tyre leksikografik.
Qëllimi kryesor i këtij studimi është të analizojë njësitë frazeologjike që përmbajnë emërtime të kafshëve shtëpiake, kafshëve të egra, shpendëve dhe peshqve, duke i shqyrtuar nga pikëpamja fjalëformuese, semantike dhe leksikografike. Për realizimin e këtij qëllimi janë përdorur metoda përshkruese, analitike dhe krahasuese, të cilat kanë mundësuar evidentimin, klasifikimin dhe interpretimin e materialit gjuhësor.
Nëpërmjet këtij trajtimi synohet të nxirret në pah roli i këtyre njësive në pasurimin e frazeologjisë shqipe, veçoritë e tyre kuptimore dhe funksioni që ato kryejnë në karakterizimin figurativ të njeriut.

Metodologjia

Metodologjia e ndjekur për ndërtmin e këtij punimi mbështetet thuajse plotësisht mbi parimin e vjeljes manuale dhe kërkimit empirik, pasi është kaluar manualisht çdo njësi leksikore, në të tre fjalorët, për të grumbulluar të plotë të gjithë lëndën e nësivë frazeologjikë që kanë në përbërje emërtimet e katër klasave të gjallesave: kafshët shtëpiake,, të egra, shpendët dhe peshqit. Pasi u mblodh e gjithë lënda(duke lënë jashtë termat shkencorë apo botanikë) njësitë frazeologjike nuk u ndanë në mënyrë të izoluar sipas klasifikimit zoologjik por u gërshetuan në një tjetër formë për të parë sesi populli (përmes gjuhes),përdor gjallesa të ndryshme(katër klasat),për të shprehur të njëjtën ide mbi njeriun a shoqërinë.

Klasifikimi tematik i njësive frazeologjike të gjallesave

Korpusi i njësive në këtë studim, për të shpeguar sa më qartë lidhjen e drejtëpërdrejtë që populli ka vendosur midids jetës natyrore të kafshës dhe përditshmërisë njerëzore, paraqitet i sistemuar në tre grupe të mëdha tematike: a) Njësi frazeologjike me emërtime të gjallesave që përshkruajnë karakterin, sjelljen, mendësinë dhe natyrën e njeriut, b)Njësi frazeologjike me emërtimetë gjallesave që përshkruajnë gjendjen sociale, pozicionin, rolin apo mënyrën e jeteses dhe mbrojtjen e individit dhe c) Njësi që përshkruajnë situata të vështira, të zmadhuara, të pamundura ose absurd në jeten e njeriut.
Njësi frazeologjike me emërtime të gjallesave që përshkruajnë karakterin, sjelljen, mendësinë dhe natyrën e njeriut.
Në këtë grup përfshihen ato njësi frazeologjike ku tipari i gjallesës (qoftë tipar fizik apo i sjelljes) transferohet drejtpërdrejt te njeriu për të bërë vlerësimin e vlerave të tij (intelektit, mendësisë, moralit, frikës, guximit apo forcës së tij), p.sh.: ***As me buaj, as me qe;[1] Nuk sheh buallin para sysh;[2]Cjapi mish e dhia tavë (dhia mish e cjapi tavë);[3](kafshë shtëpiake)Si dashi me rrurëzën;[4](kafshë shtëpiake), U bë dele;[5] Delja ku kullot, atje lë leshin;[6] Delja e zezë s'bëhet kurrë e bardhë;[7]U bë derr;[8] Punon si derr;[9] Derri do plumb;[10] M'u bë derr;[11] S'ia***

[1] **As me buaj, as me qe** i pavendosur, që nuk di nga tja mbajë, me dy mendje; as kështu as ashtu.Shih.fjalorin…
[2] **Nuk sheh buallin para sysh** nuk kupton edhe diçka që është fare e qartë.
[3] **Cjapi mish e dhia tavë (dhia mish e cjapi tavë)** si njëri edhe tjetri; po e njëjta gjë.
[4] **Si dashi me rrurëzën** shumë mirë, në pajtim të plotë.
[5] **U bë dele** iu zbardhën fare flokët, u thinj krejt.
[6] **Delja ku kullot, atje lë leshin** *fj.u*. thuhet për një njeri, i cili i shërben atij që i jep të hajë, që e paguan.
[7] **Delja e zezë s'bëhet kurrë e bardhë** *fj.u.* njeriu i lig ose armiku nuk mund të bëhet kurrë i mirë; ujku qimen e ndërron, por lëkurën nuk e ndërron
[8] **U bë derr** u mërzit shumë, plasi nga mërzia.
[9] **Punon si derr** punon shumë, i qepet e s'i ndahet punës, punon derrçe.
[10] **Derri do plumb** *fj.u.*Armiku duhet asgjësuar me mënyra e me mjete të forta, nuk ka mëshirë për armikun; e keqja duhet zhdukur menjëherë e me rrënjë.
[11] **M'u bë derr** *dikush a diçka* m'u neverit, s'e shoh dot me sy.

ha pulat dhelpra;[12] ***U bë ujk (bishë);***[13] ***Ujk i vjetër (plak);***[14]***(kafshë e egër), U bë bilbil;***[15]***(shpend), Bufi mburr zogjtë e tij;***[16] ***Dallëndyshja e parë;***[17] ***Si gjeli pa kokë(pa krye);***[18] ***Hidhet (kërcen) si gjel;***[19] ***Kapardisej(krekosej)si gjeli(si këndesi,si kaposhi) majë plehut;***[20] ***I rri gjel*** *dikujt;*[21]
Korbi korbit(sorra sorrës) s'ia nxjerr sytë; [22]***Rri si pulë;***[23] ***S'ia ha pulat dhelpra*** *dikujt;*[24] ***U bë qyqe;***[25]***Është bërë si qyqe;***[26] ***E bëri (fare) qyqe;***[27] ***S'na i ka çukitur (s'na i ka ngrënë, s'na i ka pirë) sorra (pula) mendtë;***[28] ***Shqiponja nuk ha miza;***[29] ***Shket(rrëshqet) si ngjalë;***[30] ***Peshku i madh e ha të voglin;***[31] ***I ka shkuar mendja për peshk;***[32]**etj.**

Nga shpjegimet e paraqitura në fund të faqeve të këtij punimi, vjelë nga fjalori I 80' shihet qartë se populli shqiptar I ka përdorur të katërta klasat e gjallesave për të treguar cilësitë e individit, ata të karakterit, sjelljes, mendësisë etj.

Nga shpjegimi i njësive frazeologjike, të sjella si modele përfaqësuese të klasave të gjallesave, në grupin e parë, shihet qartë se si populli shqiptar ka përdorur kafshët për të treguar cilësitë dhe veset e njeriut. Në këtë grup lidhja bëhet duke u nisur nga pamja fizike e kafshës ose nga mënyra se si ajo sillet në natyrë, në bashkëjetesë me njeriun.Te rasti **i buallit,** te shprehjet me këtë emërtim si p.sh. "***as me buaj, as me qe"*** apo "***nuk sheh buallin para sysh"***, njerëzit janë nisur nga madhësia fizike e buallit. Duke qenë se bualli është një kafshë gjigante dhe mezi lëviz, populli thotë se nëse një njeri nuk arrin të shikojë apo të dallojë diçka aq të madhe sa bualli, ai është një njeri të cilit i mungon krejtësisht vëmendja, mprehtësia dhe nuk merr vesh nga gjërat më të thjeshta e jo më të tjerat. **Te** njësitë frazeologjike si ***cjapi mish e dhia tavë*** ose ***delja e zezë s'bëhet kurrë e bardhë, tiparet fizike*** tregojnë se karakteri i njeriut nuk ndryshon dot. Populli përdor ngjyrën e deles (që nuk ndryshon dot vetvetiu) apo llojin e mishit të kafshës (që po ashtu nuk ndryshon), për të thënë se një njeri që ka lindur i prapë ose i lig,pa karakter, do të mbetet po ai dhe nuk do të bëhet kurrë i mirë, pavarësisht përpjekjeve, kushteve apo rrethanave. Në rastin e njësisë "***si dashi me rrurëzën"***, njerëzit janë nisur nga mënyra se si kafshët janë në një harmoni e shkojnë mirë e në paqe me njëra-tjetrën në tufë, për të përshkruar dy njerëz që kanë miqësi të forte, marrëdhënie të mira. Ndërsa te shprehja "***u bë dele", e këtij grupi***, lidhja është krejtësisht vizuale(ajo që duket), leshi i bardhë i deles përdoret si krahasim për të treguar një njeri që është thinjur, që është plakur dhe i janë zbardhur flokët plotësisht. Në rastin e emërtimit të kafshës shtëpiake, derr, njësitë me këtë emërtim tregojnë se kjo kafshë është përdorur në dy mënyra krejt të ndryshme në shoqërinë tonë. Nga njëra anë, (në rastin e njësive " mu bë derr", apo "derri do plumb", derri përdoret për të treguar diçka negative, të keqe, të neveritshme, ose egërsi ndaj dikujt, e nga ana tjetër , populli ka marrë

[12] **S'ia ha pulat dhelpra** *dikujt shih te* PUL/Ë,~A.
[13] **U bë ujk (bishë)** *shih te* BISH/Ë,~A.
[14] **Ujk i vjetër (plak)** njeri i rrahur me jetën; ai që e njeh mirë një punë.
[15] **U bë bilbil** u ndreq, u bë lule (për njerëz që nuk kanë qenë të rregullt).
[16] **Bufi mburr zogjtë e tij** thuhet për atë që përpiqet të mburr punën e vet edhe kur nuk vlen, shoshari shoshën e tij lëvdon.
[17] **Dallëndyshja e parë** shenja e parë e diçkaje që do të vijë me shumicë; ai që çan i pari drejt diçkaje të re e pak të njohur.
[18] **Si gjeli pa kokë(pa krye)** sikur i merren mendtë, si i trullosur, si i hutuar, si i shastisur.
[19] **Hidhet(kërcen) si gjel** merr zjarr menjëherë, zemërohet e kërcen për gjënë më të vogël.
[20]**Kapardisej(krekosej) si gjeli(si këndesi,si kaposhi) majë plehut** mbahej më të madh, krekosej.
[21] **I rri gjel** *dikujt* qëndron me mendjemadhësi përballë dikujt, krekoset para dikujt, nuk e ul kokën para dikujt, i rri kundër.
[22] **Korbi korbit(sorra sorrës) s'ia nxjerr sytë** *fj.u.* I ligu nuk i bën keq të ligut.
[23] **Rri si pulë** rri shumë urtë, nuk lëviz nga vendi e s'bën zë fare; rri i drojtur e i përulur.
[24] **S'ia ha pulat dhelpra** *dikujt* është i zoti, nuk ia hedh dot, s'ia ha qeni shkopin
[25] **U bë qyqe** piu e u deh keq, u bë tapë.
[26] **Është bërë si qyqe** është dobësuar shumë, është tretur.
[27] **E bëri (fare) qyqe** e qortoi rëndë e s'i la gjë pa thënë, e bëri leckë.
[28] **S'na i ka çukitur (s'na i ka ngrënë, s'na i ka pirë) sorra (pula) mendtë** nuk e kemi humbur mendjen, nuk jemi aq të marrë e aq budallenj që të mos e marrim vesh, të mos e kuptojmë diçka.
[29] **Shqiponja nuk ha miza** *fj.u.* njerëzit e shquar nuk merren me çikërrima e me gjëra të ulëta.
[30] **Shket(rrëshqet) si ngjalë** u bën bisht e u shpëton me dredhi gjendjeve të vështira.
[31] **Peshku i madh e ha të voglin** *fj.u.* ai që është më i fuqishëm e zhduk më të voglin ose më të dobëtin, fiton më i forti edhe kur e drejta është nga ana e më të dobëtit ose e më të voglit(karakteristikë për shoqërinë me klasa shfrytëzuese dhe për moralin borgjez).
[32] **I ka shkuar mendja për peshk** *dikujt* i ka shkuar mendja për diçka të mirë a për diçka që gjendet me vështirësi (përdoret zakonisht në vende që janë larg detit, lumenjve e liqeneve).

tiparin e forces fizike të madhe dhe këmbënguljen e kësaj kafshe për të shprehur vlerësimin për njeriun që punon shumë, pa u ndalur, (***punon si derr***).
Nga sa trajtohet më lart, ky grup i parë na tregon se njeriu e ka përkufizuar veten dhe të tjerët përreth vetes duke e parë atë në reflektimin e kafshëve për të treguar nëse është i urtë, punëtor, i egër, i butë,i paftë, i palodhur në punë apo kokëfortë.

Njësi frazeologjike me emërtimetë gjallesave që përshkruajnë gjendjen sociale, pozicionin, rolin apo mënyrën e jeteses dhe mbrojtjen e individit

Ku grupohen njësitë që pasqyrojnë pozicionin e njeriut në strukturat shoqërore, raportin e tij me kolektivin, si dhe shkallën e vetmisë, braktisjes apo pambrojtjes ekzistenciale), p.sh. ***S'është cjap për atë zile;[33](kafshë shtëpiake), Si dashi me këmborë;[34] Dash me këmborë;[35](kafshë shtëpiake), Dashi i kurbanit; [36]Delen e vetme (që ndahet nga tufa) e ha ujku;[37] Stallë (thark) derrash;[38] Jetë derrash;[39] Në gojë të ujkut;[40] Mbeti bilbil;[41](shpend), Ishte si bilbili në kafaz;[42](shpend), Janë si zogjtë e dallëndyshes;[43] Ngrihet me gjelat;[44] Fle(bie) kur këndojnë gjelat;[45] U shpërndanë si zogjtë e korbit;[46] Me pula e me zogj;[47] Këndon qyqja*** *për dikë;*[48] ***Rrit sorrën të të nxjerrë sytë;[49] Mbeti si peshku në zall (pa ujë)***;[50]
Siç kuptohet dhe nga shpjegimet, në këtë grup,njësitë frazeologjike nuk tregojnë karakterin apo sjelljen e njeriut por statusin social të tij, pozicionin apo rolin e tij udhëheqës në shoqëri, braktisjen, vetminë, pasiguritë etj.p.sh.për të treguar një njeri që ka guxim e ju prin punëve me autoritet e mençuri, populli ka marr si model kafshën që i prin tufës në jetën e përditshme, dashin, (**Si dashi me këmborë; Dash me këmborë etj.).** Ndërkohë përdor shpendët e vegjël e të braktisur për të treguar një njeri që ka mbetur vetëm, pa njeri, pa kujdes e pa përkrahje. *(Janë si zogjtë e dallëndyshes etj.)* Ndërsa kushtet e këqija, të rënda e të papërshtatshme të jetesës i krahason me ambjentin e pisët e të rëndë të derrit (*jetë derrash, stallë derrash)*etj..Gjithashtu, përmes njësisë me emërtimin e peshkut, "*Mbeti si peshku në zall (pa ujë)*", populli ka nxjerrë në pah një jetë të jetuar pa asnjë mjet jetese normale, një jetë në një situatë të ngushtë, pamundësie të madhe. Ndërkaq, ndjenjen e sakrificës për të tjerët, rrezikut a mosmirënjohjes, zhgënjimit prej dikujt, pozicionin e njeriut përballë tyre e ka nxjerrë në pah përmes njësive me emërtime të kafshës shtëpiake të dashit *(dashit të kurbanit)*njeriu që sakrifikohet për të tjerët, familjen shoqërinë etj., sorrës (*rrit sorrën të të nxjerrë sytë),*zhgënjimin prej dikujt që e ke ndihmuar, i ke bërë mirë, apo kafshës së egër, ujkut, (në gojë të ujkut) për të treguar rrezikun e madh.

[33] **S'është cjap për atë zile** *shih te* ZIL/E,~JA.
[34] **Si dashi me këmborë** *shih te* KËMBOR/Ë,~A.
[35] **Dash me këmborë** *shih te* KËMBOR/Ë,~A.
[36] **Dashi i kurbanit** *shih te* KURBAN,~I.
[37] **Delen e vetme (që ndahet nga tufa) e ha ujku** *fj.u.* ai që ndahet nga shokët , nga kolektivi e pëson keq.
[38] **Stallë (thark) derrash** *keq.* dhomë, sallë etj. e fëlliqur, e mbajtur shumë keq.
[39] **Jetë derrash** jetë e rëndë, jetë e ndyrë.
[40] **Në gojë të ujkut** i rrethuar nga armiq të egër, fare pranë një rreziku të mundshëm.
[41] **Mbeti bilbil** mbeti fare pa gjë ose pa njeri.
[42] **Ishte si bilbili në kafaz** ishte i mirë e i zoti dhe i kishte të gjitha për të jetuar,por nuk kishte liri; ishte pa liri e pa shpresë.
[43] **Janë si zogjtë e dallëndyshes** janë fare të brishtë e të pafuqishëm dhe kanë nevojë për ndihmë, përkrahje e kujdes të drejtpërdrejtë.
[44] **Ngrihet me gjelat** ngrihet, zgjohet herët në mëngjes.
[45] **Fle(bie) kur këndojnë gjelat** fle (bie) vonë.
[46] **U shpërndanë si zogjtë e korbit** u shpërndanë nga të katër anët dhe asnjëri nuk di ku gjendet tjetri, u shpërndanë andej-këndej në vende të ndryshme(për njerëzit).
[47] **Me pula e me zogj** me gjithë njerëzit e shtëpisë, me qen e me mace.
[48] **Këndon qyqja** *për dikë* a) e prêt e zeza (përdoret si kërcënim për dikë); b) nuk kujdeset askush për dikë, e kanë braktisur, nuk e përfill më asnjeri.
[49] **Rrit sorrën të të nxjerrë sytë** i bën mirë një mosmirënjohësi.
[50] **Mbeti si peshku në zall (pa ujë)** mbeti pa mjete jetese, është në ngushticë të madhe, mbeti pa gjë fare.

Njësi që përshkruajnë situata të vështira, të zmadhuara, të pamundura ose absurd në jeten e njeriut

Kwtu përmblidhen njësitë që përdoren për të treguar rrethana a situate të caktuar të jetës, ngjarje të papritura të fatit, ose përpjekje të kota për të nxjerrë dobi aty ku nuk mundet (p.sh. ***E bën buall;[51] Më sa hyn bualli në veshin (në vrimën) e gjilpërës;[52] Hall me buaj, hall me qe;[53](kafshë shtëpiake), Të shtie miza e s'të nxjerr bualli;[54] U fut (hyri) në bri të buallit (të kaut);[55] Dhjamë cjapi;[56](kafshë shtëpiake), Shkoi (vajti) si cjapi te kasapi;[57](kafshë shtëpiake), Është (mbeti) si daci në gaviç;[58](kafshë shtëpiake), Kërkon shtjerrat e deshve;[59](kafshë shtëpiake), S'dalin dy lëkura nga një dele(nga një berr);[60] Nuk fle (nuk kullot) delja me ujkun bashkë;[61] Kërkon qumësht nga delja shterpë;[62] Si delja në hell;[63] Pëlcet derrin;[64](kafsha shtëpiake), Pëlcet derri;[65](kafshë shtëpiake). Nuk ka pyll pa derra;[66] Si derri në thark;[67] Kur s'ke pula pse hahesh me dhelprat?(mos u merr me dhelprat!);[68]Fut ujkun në vathë;[69](kafshë e egër), Me thonjtë e bufit;[70] E di edhe bufi;[71] Me një dallëndyshe (me një lule) s'vjen pranvera (behari);[72] Qumësht dallëndysheje;[73] I bën edhe gjeli vezë;[74](shpend), Kur të zbardhet penda e korbit;[75] Sa të zbardhet penda e korbit;[76] Si pula pa krye (pa kokë);[77] I ka kënduar qyqja(dikujt);[78] Si qyqja verën;[79] Më sa rri sorra në dy hunj (si sorra në dy hunj);[80] E pagoi si prifti sorrën;[81] Gjeti vezët e thëllëzës;[82] Kusia mbi prush, thëllëza në fushë;[83] Përzihet si bolla me ngjalën;[84] Peshku në det, tigani në zjarr;[85]***

Në këtë grup të tretë, siç kuptohet dhe nga shpjegimet përkatëse, njësitë tregojnë situata komplekse të jetës, dilema apo ngjarje të fatit të cilat njeriu I ka shprehur përmes njësive të ndryshme me emërtime të kafshëve . Psh ngjarjet, situatat apo dilemat ku çdo zgjidhje, cila do qoftë, mbetet e keqe, populli i ka shprehur përmes kafshëve të punës *(hall me buaj, hall me qe),* ndërsa situatat në ankth, në vështirësi i ka shprehur përmes deles në therje (si delja në

[51] **E bën buall** *diçka* e zmadhon diçka tej mase, e fryn së tepërmi.
[52] **Më sa hyn bualli në veshin (në vrimën) e gjilpërës** kurrë, asnjëherë; është e pamundur të bëhet.
[53] **Hall me buaj, hall me qe** keq sido që të bëhet, keq kështu e keq ashtu.
[54] **Të shtie miza e s'të nxjerr bualli** *shih te* MIZ/Ë,~A.
[55] **U fut (hyri) në bri të buallit (të kaut)** *shih te* BRI,~RI.
[56] **Dhjamë cjapi** diçka pa fitim, pa leverdi.
[57] **Shkoi (vajti) si cjapi te kasapi** e gjeti të keqen vetë me këmbët e tij; shkoi vetë pa e ditur se ç'rrezik a ç'e keqe e priste.
[58] **Është (mbeti) si daci në gaviç** është në gjendje të keqe, është zënë ngushtë, nuk di nga t'ia mbajë.
[59] **Kërkon shtjerrat e deshve** kërkon diçka të pamundur.
[60] **S'dalin dy lëkura nga një dele(nga një berr)** *fj.u. shih te* LËKUR/Ë,~A1.
[61] **Nuk fle (nuk kullot) delja me ujkun bashkë** *fj.u.* nuk mund të ketë paqe e bashkëpunim ndërmjet atij që është i ndershëm e punëtor dhe armiqve të egër e të pabesë. Djalli s'ka dele dhe shet lesh shih te DJALL,~I.
[62] **Kërkon qumësht nga delja shterpë** *shih te* QUMËSHT,~I.
[63] **Si delja në hell** në gjendje shumë të vështirë, pa asnjë shpresë shpëtimi.
[64] **Pëlcet derrin** *dikush a diçka* të fryn e të zemëron pa masë; të mërzit shumë.
[65] **Pëlcet derri** është shumë vapë , është vapë e padurueshme
[66] **Nuk ka pyll pa derra** *fj.u.* bashkë me të mirat do gjesh edhe ndonjë gjë të keqe; s'janë të gjithë të mirë, midis shumë të mirëve ka edhe ndonjë të keq.
[67] **Si derri në thark** shumë i mërzitur.
[68] **Kur s'ke pula pse hahesh me dhelprat ? (mos u merr me dhelprat!)** *shih te* PUL/Ë,~A.
[69] **Fut ujkun në vathë** *shih te* VATH/Ë,~A.
[70] **Me thonjtë e bufit** shumë keq, shkel e shko, me këmbët e pulës.
[71] **E di edhe bufi** *thjeshtligj*. është fare e thjeshtë dhe e kuptueshme, s'ka nevojë të shpjegohet a të tregohet.
[72] **Me një dallëndyshe (me një lule) s'vjen pranvera (behari)** *fj.u. shih te* LUL/E,~JA
[73] **Qumësht dallëndysheje** *shih te* QUMËSHT,~I.
[74] **I bën edhe gjeli vezë** i ecën shumë mbarë, i ka punët shumë mirë, i ka të gjitha të mirat.
[75] **Kur të zbardhet penda e korbit** kurrë, asnjëherë.
[76] **Sa të zbardhet penda e korbit** gjithnjë, pa fund, gjithë jetën.
[77] **Si pula pa krye (pa kokë)** i shushatur, i hutuar.
[78] **I ka kënduar qyqja** *dikujt a diçkaje* nuk vjen më, nuk përsëritet më, nuk kthehet më, ka mbaruar.
[79] **Si qyqja verën** me kursim të madh, me frikë se mos i mbarohet.
[80] **Më sa rri sorra në dy hunj (si sorra në dy hunj)** asnjëherë, kurrë, kurrën e kurrës.
[81] **E pagoi si prifti sorrën** pagoi shumë shtrenjtë, e pagoi si frëngu pulën.
[82] **Gjeti vezët e thëllëzës** a) arriti a bëri diçka thuajse të pamundur; b) *iron*. e pa mirë se ç'mund të bënte; e pa sa pisk e kishte.
[83] **Kusia mbi prush, thëllëza në fushë** *fj.u. shih te* KUSI,~A.
[84] **Përzihet si bolla me ngjalën** *shih te* BOLL/Ë,~A
[85] **Peshku në det, tigani në zjarr** *fj.u. iron*. thuhet kur një punë ende s'është kryer, kurse dikush kërkon para kohe të gëzojë të mirat që do të vijnë prej saj pasi të përfundojë; është tepër herët për diçka.

hell)apo derrit(si derri në thark).Ndërkohë situatat kur njeriu futet vetë në tëlash, rrezik përmes veprimeve a vendimeve të tij e ka shprehur përmes cjapit apo dhelpres (*shkoi si cjapi te kasapi, Kur s'ke pula pse hahesh me dhelprat?(mos u merr me dhelprat!).*
Po ashtu, përmes anatomisë së shpendëve, ndryshimit të ngjyrës që smund të ndodh apo përmasave të pamundura , populli ka shprehur situatat që nuk mund të realizohen a të ndodhin, që janë në kushtet e pamundësisë absolute, psh. Kur të zbardhet penda e korbit, Më sa hyn bualli në veshin (në vrimën) e gjilpërës etj.) Gjithahstu, gëzimin e parakohshëm apo nxitimin për një ngjarje, punë a ndodhi e ka shprehur përmes njësive të llojit(peshku në det, tigani në zjarr,kusia mbi prush, thëllëza në fushë), ndërsa fatin e papritur e të madh e shpreh me njësinë e kafshës shtëpiake të gjelit: I bën edhe gjeli vezë. Nga njësitë e vjela kuptohet që popullit si kanë shpëtuar as përpjekjet e kota apo zmadhimet e tepërta pa I shprehur përmes kafshëve, kështu zmadhimin e një situatë të zakonshme e kanë nxjerrë në pah përmes buallit(e bën mizën buall)apo kërkesat absurbe I kanë shprehur me njësi të deles, dashit etj.(kërkon qumësht nga delja shterpë, kërkon shtjerrat e deshve).Në këtë grup përmes njësisë " të shtie miza e stë nxjerr bualli", kuptohet sesi populli ka tejçuar përmes kafshëve telashin a rrezikun e madh që vjen prej një problem të vogël në fillim e që më tej shndërrohet në një bllokim a ngërç të madh.

Struktura fjalëformuese e njësive frazeologjike të emërtimeve të gjallesave

Krahas trajtimit në nënçështjet më lart, njësitë frazeologjike me prani të emërtimeve të gjallesave, ngjallin interes të vështrohen edhe në një tjetër aspekt,mjaft të rëndësishëm, atë të fjalëformimit të tyre. Nga përdorimi dhe ngultitja e tyre, me kohën në gjuhë, njësitë frazeologjike fillojnë e humbasin kuptimin e fjalëve që i përbëjnë ato dhe fillojnë e sillen si një fjalë e vetme, duke marrë rolin e një pjesë të caktuar të ligjeratës. Duke parë strukturën e njësive të vjela për këtë qëllim, të kategorizuara më lart, mund të themi se njësitë frazologjike ku gjenden emërtime të gjallesave të ndryshme mund të ndahen në tre modele të ndryshme fjalëformuese: Lokucione emërore, lokucione mbiemërore, lokucionet foljore dhe lokucione ndajfoljore.

Lokucione emërore (që sillen si emra)

Në këtë grup përfshihen ato njësi frazeologjike, që janë ndërtuar si bashkime të tipit emër+mbiemër ose emër+emër dhe që në fjali, luajnë rolin e një emri të vetëm për të emërtuar një lloj njeriu. Nga korpusi i madh i njësive frazeologjike me emërtime të gjallesave mund të përmendim këtu shembuj të shumtë: *Ujk i vjetër (plak,* njeri me përvojë); *Dallëndyshja e parë* (nismëtari); *Dashi i kurbanit* (viktima); *Stallë (thark) derrash*(mjedis i fëlliqur); *Jetë derrash* (zëvendëson emrin: mjerim); etj.

Lokucione mbiemërore

Në këtë grup futen ato njësi frazeologjike që sillen dhe marrin vlerën e një mbiemri, duke shërbyer për të cilësuar apo përshkruar drejtpërdrejt një tipar, ves, paaftësi ose një gjendje të njeriut. P.sh.*As me buaj, as me qe (i pavendosur); S'është cjap për atë zile (i paaftë); Si dashi me këmborë (udhëheqës); Janë si zogjtë e dallëndyshes (të pafuqishëm);Dhjamë cjapi (i pafrytshëm) etj.*

Lokucionet foljore

Klasa e lokucioneve foljore është më e madhja e njësive frazeologjike me emërtime të gjallesave. Këtu përfshihen të gjitha ato njësi të cilat kanë në bërthamën e tyre një folje të gjallë

ose që në fjali sillen si një folje e vetme, duke shprehur një veprim aktiv, një proces të caktuar apo një ndryshim të gjendjes shpirtërore e fizike të njeriut. *Nuk sheh buallin para sysh* (nuk kupton); *U bë dele* (u thinj); *Delja ku kullot, atje lë leshin* (i shërben përfituesit); *Delja e zezë s'bëhet kurrë e bardhë* (nuk ndryshon i ligu); *U bë derr* (u mërzit); *Punon si derr* (sforcohet); *Derri do plumb* (zëvendëson foljen: duhet asgjësuar e keqja); *M'u bë derr* (zëvendëson foljen: m'u neverit); *S'ia ha pulat dhelpra* (zëvendëson foljen: nuk gënjehet); *U bë ujk*(zëvendëson foljen: u egërsua); *U bë bilbil* (zëvendëson foljen: u ndreq); *Bufi mburr zogjtë e tij*(zëvendëson foljen: lavdëron të vetët pa meritë); *Hidhet si gjel* (zëvendëson foljen: zemërohet shpejt); *Kapardisej si gjeli majë plehut* (zëvendëson foljen: mburrej pa vlerë); *I rri gjel dikujt* (zëvendëson foljen: krekoset); *Korbi korbit s'ia nxjerr sytë* (zëvendëson foljen: bashkëpunojnë të ligjtë); *Rri si pulë*(zëvendëson foljen: bindet); *U bë qyqe* (zëvendëson foljen: u deh/u dobësua); *E bëri qyqe* (e qortoi rëndë); *S'na i ka çukitur sorra mendtë* (gjykojmë); *Shket si ngjalë* (dredhon); *Peshku i madh e ha të voglin* (shtyp i forti); *I ka shkuar mendja për peshk* (lakmon diçka të mirë); *Delen e vetme e ha ujku* (dëmtohet i vetmuari); *Mbeti bilbil*(u varfërua); *Ngrihet me gjelat* (zgjohet herët); *Fle kur këndojnë gjelat* (bie vonë); *U shpërndanë si zogjtë e korbit* (u përçanë); *Këndon qyqja për dikë* (harrohet); *Rrit sorrën të të nxjerrë sytë* (tradhtohet); *Mbeti si peshku në zall* (u bllokua); *E bën buall diçka* (ekzagjeron); *Të shtie miza e s'të nxjerr bualli* (të bllokon gabimi i vogël); *U fut në bri të buallit* (u fsheh); *Shkoi si cjapi te kasapi* (rrezikon vetveten); *Kërkon shtjerrat e deshve* (kërkon të pamundurën); *Nuk fle delja me ujkun bashkë*(armiqtë nuk pajtohen); *Kërkon qumësht nga delja shterpë* (kërkon dobi pa produkt); *Pëlcet derri* (bën vapë mbytëse); *Pëlcet derrin* (nxit tërbim); *Nuk ka pyll pa derra* (bashkëjeton e keqja); *Fut ujkun në vathë* (sjell rrezikun brenda); *E di edhe bufi* (është e njohur botërisht); *Me një dallëndyshe s'vjen pranvera* (nuk mjafton një përpjekje); *I bën edhe gjeli vezë* (zëvendëson foljen: ka mbarësi); *I ka kënduar qyqja dikujt* (zëvendëson foljen: ka përfunduar); *E pagoi si prifti sorrën*(u ndëshkua financiarisht); *Gjeti vezët e thëllëzës* (arriti të pamundurën); *Kusia mbi prush, thëllëza në fushë* (nxiton para kohe); *Përzihet si bolla me ngjalën* (shoqërohet me njerëz të mbrapshtë); *Peshku në det, tigani në zjarr*(gëzohet para kohe).

Lokucione ndajfoljore

Ky grup përmbledh ato njësi frazeologjike të cilat janë ngulitur me kohën dhe luajnë rolin e një ndajfoljeje të thjeshtë. Ato shërbejnë për të treguar mënyrën se si kryhet një veprim, rrethanat e jashtme ose kohën ekzakte se kur ndodh një ngjarje në jetën e njeriut. Strukturisht, ky model ndërtohet pothuajse gjithmonë përmes lidhëzave apo parafjalëve krahasuese (si, sikur, sa) të ndjekura nga emri i gjallesës. Në ligjërim, këto njësi u përgjigjen pyetjeve praktike *si?*, *kur?* ose *sa?* dhe plotësojnë kuptimin e foljeve. Psh.*Si dashi me rrurëzën* (në paqe); *Si gjel pa kokë* (në panik); *Në gojë të ujkut* (rrezik); *Me pula e me zogj* (familjarisht); *Më sa hyn bualli në veshin e gjilpërës* (kurrë); *Si delja në hell* (në ankth të madh); *Me thonjtë e bufit* (keq); *Kur të zbardhet penda e korbit* (asnjëherë); *Sa të zbardhet penda e korbit* (përjetë); *Si pula pa krye*(në mënyrë të hutuar); *Si qyqe verën* (me kursim); *Më sa rri sorra në dy hunj* (kurrë).

Sa më lart, analiza fjalëformuese e njësive, na dëshmon se korpusi I tyre ka një rregullsi të plotë gjuhësore dhe që populli nuk ka krijuar shprehje rastësore por ka shfrytëzuar modelet e fjalëformimit të shqipës për ti kthyer emërtimet e gjallesave në emra, mbiemra, folje e ndajfolje me qëllim që të përshkruajnë në mënyrë sa më të plotë, veprimet, veset, natyren e njeriut.Kështu psh. Sa herë u duhej të përshkruanin një tip njeriu kanë krijuar një emër(ujk i vjetër), nëse u duhej të tregonin një ves , krijuan një mbiemër(kokë derri,kokëfortë) dhe nëse u duhej një të përshkruanin një gjendje a proces, krijuan një folje(u bë pulë).

Gjithashtu, nga vështrimi i imtësishëm i analizës fjalëformuese, del në pah se klasa e lokucioneve foljore është më e përhapura dhe më e gjalla në korpusin e njësive frazeologjike që kanë në përbërje emërtime të gjallesave. Kjo tregon se poppulli shqiptar e ka parë botën e kafshëve gjithnjë në lëvizje, në veprim e mjaft dinamike dhe nuk është mjaftuar duke e përshkruar njeriun në mënyrë passive(me emra apo mbiemra)por e pasqyron atë në dinamikën e saj, në mënyren si vepron apo si ndryshon pra përmes foljeve.

Rezultatet

Nga analiza e njësive frazeologjike që kanë në përbërjen e tyre emërtime të kafshëve shtëpiake, kafshëve të egra, shpendëve dhe peshqve, u evidentuan disa veçori strukturore, fjalëformuese dhe leksiko-semantike.

Së pari, nga krahasimi i tri veprave leksikografike, *Fjalori i gjuhës shqipe* (1954), *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe* (1980) dhe *Fjalori i gjuhës shqipe* (2006), rezultoi se njësitë frazeologjike të shqyrtuara u pasqyruan kryesisht në fjalorin e vitit 1980, ndërsa në dy fjalorët e tjerë ato nuk u evidentuan në të njëjtën mënyrë. Ky konstatim nxori në pah dallime në përzgjedhjen dhe trajtimin e materialit frazeologjik në tri veprat leksikografike.

Së dyti, në pikëpamje strukturore dhe fjalëformuese, u vu re mbizotërimi i njësive frazeologjike me strukturë foljore. Këto njësi paraqitën një përdorim të gjerë në shprehjen e veprimeve, sjelljeve dhe qëndrimeve njerëzore. Struktura foljore dëshmoi aftësinë e frazeologjisë për të karakterizuar njeriun jo vetëm nëpërmjet cilësive të tij, por edhe nëpërmjet mënyrës së veprimit dhe të reagimit në situata të ndryshme.

Së treti, analiza leksiko-semantike evidentoi një vështrim të larmishëm dhe të gjallë të karakteristikave njerëzore. Emërtimet e gjallesave u përdorën në mënyrë të figurshme për të shprehur cilësi pozitive dhe negative, si trimëria, dinakëria, zgjuarsia, kokëfortësia, frika, naiviteti, dembelizmi dhe vese të ndryshme njerëzore. Këto njësi dëshmuan pasurinë shprehëse të frazeologjisë shqipe dhe rolin e saj në pasqyrimin e botëkuptimit dhe të vlerësimeve shoqërore.

Në tërësi, rezultatet treguan se njësitë frazeologjike me emërtime gjallesash përbëjnë një pasuri të rëndësishme leksikore e semantike, në të cilën ndërthuren veçoritë strukturore, kuptimore dhe kulturore të gjuhës shqipe.

Referencat

[1] Çipo,K.,Çabej,E.,Domi,M.,Krajni,A.,Myderrizi,O., "*Fjalori i gjuhës shqipe",*Tiranë, 1954.

[2] Kostallari ,A.,*Parimet themelore për hartimin e"Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe*"SF 1968,II.

[3] Kostallari, A., *Gjendja e studimeve albanologjike në Shqipëri.Probleme dhe detyra të reja*, Konferenca e parë e studimeve albanologjike, 1965.

[4] Kostallari,A.,Thomai.J.,Lloshi,Xh.,Samara,M., Kole,J., Daka,P. ,Haxhillazi,P.,Shehu ,H,Leka,F.,Lafe,E.,Sima,K.,Feka,Th.,Keta,B.,Hidi,A., *"Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*", Tiranë, 1980.

[5] Lloshi,Xh., "*Mbi rezultatet kryesore në studimin e leksikut dhe të formimit të fjalëve në gjuhën shqipe pas çlirimit"*, Studime mbi leksikun dhe mbi formimn e fjalëve në gjuhën shqipe I, Tiranë, 1972.

[6] Metani,I., "*Vështrim leksiko-semantik i emërtimeve të njerëzve sipas tipareve fizike e morale në gjuhën shqipe*", Studime Filologjike 1-2, Tiranë, 2004.

[7] Thomai,J., Samara,M., Haxhillazi,P., Shehu,H., Feka,Th.,Memisha,V., Goga,A., *"Fjalori i gjuhës shqipe*",Tiranë, 2006.

[8] Thomai, J., *Zhvillimi i teorisë dhe i praktikës leksikografike shqiptare pas çlirimit,* Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe II, Tiranë, 1972.

[9] Xhuvani,A., *Për pastërtinë e gjuhës shqipe,* 1956.